| | | | Prishtinës”;<br><br>3.17 Trajnim me gratë në fshatin Barilevë, me temën: “Për një jetë pa dhunë me bazë gjinore”, ku diskutuam dhunën në baza gjinore dhe në familje , pasojat që shkakton dhuna në familje dhe shoqëri, dhe si të kërkojmë ndihmë;<br><br>3.18 “Muaji kundër kancerit të gjirit”, në bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë, kemi organizuar mamografi falas për gratë të cilat dëshirojnë të lajmërohen, video-spot vetëdijësuese dhe në shenjë të simbolikës është vendosur kordelja roze me lule në oborrin e Komunës së Prishtinës dhe ndriçimi i disa objekteve me ngjyrë rozë, ku kishte edhe fushatë me të njëjtën moto “Prishtina Rozë”. Vizitat në QMF me Komitetin për barazi gjinore dhe një ditë transporti i trafikut urban, ka qen falas për të gjitha gratë të cilat e kanë përdorur;<br><br>3.19 Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për trafikimin me qenie njerëzore, në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave të mesme të ulta dhe shkollave të mesme të larta të Komunës së Prishtinës, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, me qëllim që nxënësit të vetëdijesohen lidhje me këtë dukuri, ku kjo dukuri negative shpesh fillon edhe me dëshirën për një jetë më të mirë dhe përfundon me shkeljen e të drejtave elementare të njeriut - me skllavërim, (aktivitete janë zhvilluar duke mbajtur ligjerat/ diskutim nga vetë nxënësit, art , instalacione dhe video film; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 3.20 Mbajtja e takimit të përbashkët me përfaqësueset nga organizata ‘‘ Peace Woman Across the Globe” (PWAG), Berni i Zvicrës. **Znj. Ruth-Gaby Vermot, drejtoreshë ekzekutive dhe Znj. Annemarie SANCAR, menaxhere e programit dhe rrjetit PWAG.** Gjatë takimit u diskutuan sfidat e grave pas luftës në Kosove, deri te pozitat vendimmarrëse e grave tani;<br><br>3.21 Fushata “16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore” e cila fillon me 25 nëntor dhe përfundon më 10 dhjetor, kur shënohet edhe dita ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Qëllimi i fushatës është ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë dhe fuqizimi i ndërgjegjësimit mbi fenomenin në fjalë;<br><br>3.22 Me rastin e Ditës ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, së bashku me Komitetin konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, kemi organizuar një tryezë kushtuar kësaj dite, me temën “Qasja dhe fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar në komunën e Prishtinës”;<br><br>3.23 Mbledhja e Asamblesë së fëmijëve, pranim-dorëzim i mandatit dhe ndarja e mirënjohjeve anëtarëve të Asamblesë komunale të fëmijëve, Ristrukturimi i Asamblesë së fëmijëve për mandatin **2022-2024**;<br><br>4. Nuk kemi buxhet të ndarë, aktivitetet realizohen në bashkëpunim me drejtoritë komunale ose me OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare;<br>5. Shih më lart aktivitete e listuara, gjithesej janë | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 23;<br><br>www.prishtinaonline.com | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 1. A ka hartuar komuna juaj Strategjinë kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?<br><br>2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?<br><br>3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj ?<br><br>4.Cfarë masa ka ndërrmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?<br><br>5. Cfarë ka ndërrmar komuna juaj ndonjë veprim për rritjen e vetëdijes së publikut për dhunën në familje?? | 1. Jo. Komuna e Prishtinës nuk e ka hartuar Strategjinë kundër dhunës në familje, konfrom Strategjisë kombëtare;<br><br>2. Jemi në përfundim të Planit kundër dhunës në familje 2023-2025,<br><br>3. Qendra për Punë Sociale, deri në muajin nëntor 2022 janë evidentuar **258** raste të dhunës në familje, e deri në fund vitit piten të jenë rreth 300. Nga ky numër rreth 200 dhunë në baza gjinore, kurse raste tjera të përfshirë edhe anëtarët tjerë të familjes, prind fëmijë dhe anasjelltas;<br><br>4. Komuna i ka ndërmarrë të gjitha masat ligjore, duke siguruar strehim përmes OJQ, siguruar secilit rast menaxherin e rastit, ndihmën sociale kur është kërkuar, banimin social, pako të ndryshme, përfaqësim në gjykatë dhe polici, sigurim të punëtorit kujdestar për 24 orë;<br><br>5. Kemi mbajte fushata të ndryshme nëpër shkolla, tryeza e debate me partnerë, debate televizive etj.;<br><br>6. Po. Në Komunën e Prishtinës Mekanizmi komunal kundër dhunës, është themeluar në korrik të vitit 2015 ndërsa më 15 prill 2019 është nënshkruar edhe | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 6. A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave te dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur? | marveshja e mirëkuptimit, dhe nga atëherë si koordinatore e grupit, organizoj mbledhjet e rregullta, ku kemi shqyrtuara rastet e dhunës në familje, trafikimin dhe ngacmimet seksuale, pjesëmarrës janë QPS, Policia e Kosovës, Mbrojtësit e viktimave, Strehimorja, CLARD, ndihmë juridike falas etj.<br>Në bashkëpunim me OSBE-në, kemi punuar një udhëzues për ofruesit e kujdesit shëndetësor të linjës së parë në identifikimin, regjistrimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. MKKDHF mban mbledhje të rregullta dhe sipas nevojësë; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?<br><br>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë ?<br><br>3. Saështe numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj? | 1. Në Administratë komunale janë 7 (shtatë) gra, drejtore të drejtorive komunale;<br>Në 8 kopshtet janë 8 gra drejtore;<br>Shkolla të mesme jane 13, ku prej tyre drejtore janë **3** (tri) gra, ndërsa zëvendësdrejtore është **1** (një) grua;<br><br>Udhëheqës sektori në adm. komunale janë **11** gra dhe 29 burra;<br><br>Shkolla fillore gjithsej 45, duke përfshirë edhe shkollën në gjuhën serbe në Bërnicë, drejtor mashkuj janë 28, ndërsa drejtore gra janë **16,** kurse zëvendësdrejtorë meshkuj janë 5 dhe gra janë **8**.<br><br>2. Në Kuvendin komunal janë gjithsejtë **51** anëtarë, **18** gra dhe **33** burra;<br><br>Në Administratën e Komunes janë gjithsejtë **552** punonjës, nga ta **257** gra **295** burra; nga pjesetare të komunitetit serb janë **12**, ashkali **1**, turk **3**, boshnjak **2;**<br><br>3.Nga **16** Drejtori që i ka Komuna, **7** drejtori udhëhiqen nga drejtore gra, **9** drejtori nga drejtorë burra. | |
| 4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/ Zyra për Barazi Gjinore** | 1. Cilat janë veprimet që ka ndërrmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre? | Udhëzim administrativ (QRK), nr. 02/2020, për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (QRK) nr. 03/2016, për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve? | 2. Ne vitin 2022 janë pranuar 551 kërkesa për regjistrim të pronës në emer të të dy bashkëshortëve; | |
| 4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës | | 1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?<br><br>2.A ka ndonjë mekanizëm të veçantë komuna e juaj me të cilin promovohet dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve ?<br><br>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësuses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e | 1. **Mungesa e infrastrukturës ligjore, e paraparë me ligj, e cila është përgjegjësi e nivelit qendror për financim dhe ndërtim, sidomos të shtëpisë për fëmijë;**<br><br>2. Po, në kuadër të Njësisë për të drejtat e njeriut dhe Asambleja Komunale e Fëmijëve;<br><br>3. Asambleja Komunale e Fëmijëve është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe është ambient ku vazhdimisht promovohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve;<br><br>- Asambleja e fëmijëve ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2022. Gjatë kësaj mbledhje, kryetarja e Asamblesë së Fëmijëve, Era Hysaj , raportoi para të pranishmëve për punën e Asamblesë së Fëmijëve gjatë viti 2021;<br><br>Të pranishëm në ketë mbledhë ishte Kryetari i Komunës, z. Përparim Rama;<br><br>- Në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Njësinë e kërkim-shpëtimit, u shënua Dita Ndërkombëtare e Pyjeve. Aktiviteti u zhvillua | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të drejtave te fëmijëve në komunën tuaj,<br><br>4. Nëse po, u lutem specifikoni numrin e fushatave?<br><br>5. A është caktuar njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?<br><br>6.A ka ndarë komuna juaj mjete financiare për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, nëse po ju lutem specifikoni shumën? | ne parkun e Gërmisë.<br><br>- 12 prill, Dita ndërkombëtare e fëmijëve në situatë rruge, së bashku me Asamblenë e Fëmijëve – Komuna e Prishtinës dhe drejtoren e Mirëqenies Sociale, Adrelina Sahiti, vizituam Qendrën ditore të fëmijëve në situatë rruge, me moton e kësaj fushate “Fëmijët të edukohen, luajnë e gëzojnë, të rriturit le t‘punojnë.<br><br>- Më 1 qershor u mbajt mbledhja solemne për të drejtat e fëmijëve, ku u prezantua edhe raporti nga organizata Save the Children, raport që shprehu më së miri preokupimet e fëmijëve në mbarë shtetin tonë, ku janë përfshirë 16 komuna, gjithashtu edhe Kryeqyteti. 5. **Nga data 25-29 qershor 2022**, Asambleja e Fëmijëve ka qen pjesë e projektit “Power4Youth Leaving Care”, i përkrahur nga Erasmus+ **në SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosove**, ku ka prezantuar para fëmijëve punën e Asamblesë Komunal dhe ka qenë pjesë e diskutimeve. Pjesëmarrës në këtë vizitë kanë qenë edhe të rinj të moshave 17+, si dhe një koordinator nga shtetet: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Polonia dhe Bullgaria.<br><br>- Me rastin e shënimit të Ditës memorialë për zyrtarët policorë të rënë në krye të detyrës, më 26.7.2022, në bashkëpunim me Policin e Kosovës , Asambleja e Fëmijëve, Komuna e Prishtinës ishte pjesë e ceremonisë përkujtimore të 21 policëve të rëne në detyrë. 26 korriku është data e policëve heronj të vendit tonë, të cilët nuk kursyen as vetën në mbrojtje të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | sovranitetit dhe integritetit territorial.<br>- Mbledhja e Asamblesë së fëmijëve, pranim-dorëzim i mandatit dhe ndarja e mirënjohjeve anëtarëve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Ristrukturimi i asamblesë së fëmijëve për mandatin 2022-2024.<br>4. Në proces<br>5. Shumat e ndara janë dhënë kryesisht përmes OJQ-ve të licencuara dhe thirrjes së fundit, ku kanë përfituar mbi 300 000 euro, 34 OJQ; | |
| 4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** | 1.Sa raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?<br>2.A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat e kundër trafikimit ?<br>3. A është e hapur dhe | 1. Kemi pasur 5 raste të trafikimit dhe të gjitha kanë qenë të strehuara në strehimoret aktuale, të vlerësuara me rrezikshmëri të lartë dhe të mesme, ashtu edhe në strehimore për rrezikshmëri të ulët;<br>3. Përkrahja përmes shërbimeve sociale profesionale, caktim të menaxherit të rastit, strehim dhe riintegrim; | . |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | funksionale strehimorja për viktimat e trafikimit në komunë tuaj?<br><br>4.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeqar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?<br><br>6. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin tre-vjeqar për strehim Social ? | 4. Po. Funksionojnë tri llojet e strehimoreve;<br><br>5. Jemi duke e finalizuar dhe së shpejti paraqitet në Kuvend Komunal; | |
| 4.7.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar | | 1. A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me nevoja të veçanta në komunën tuaj? | 1. Me Vendimin e dt. **29.07.2019,** është emëruar Komisioni prej **7** anëtarëve, për Komitetin konsultativ për personat me aftëi të kufizura; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie<br><br>**7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan**. | **Drejtoria e Administratës** | 1. A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas? **(Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë).**<br><br>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konfrom Ligji nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas ?<br><br>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj? | 1. Në Prishtinë funksionon Zyra për ndihmë juridike falas dhe kemi bashkëpunim të mirë (QPS); | |
| **5 .MBROJTJA E MINORITETEVE** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5.1.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal | | 1. Sa është numri i të punësuarave të komuniteteve jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë? | 1. Në Komunën e Prishtinës janë të punësuar 20 zyrtarë të komuniteteve jo shumicë; | |
| 5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim** | 1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom dhe Ashkali?<br><br>3. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan?<br><br>4. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian ?<br><br>5. Sa është numri i | 1. Gjatë periudhës raportuese është realizuar fushata për regjistrimin falas të komuniteteve rom dhe ashkali, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës;<br><br>2. Plani lokal i veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, është miratuar nga viti 2018 dhe të gjitha projektet që dalin nga ky plan zbatohen nga ZKKK;<br><br>3. Nuk është themeluar Komiteti lokal veprues;<br><br>Gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2022, ne kemi pasur persona të zhvendosur, të rikthyer, nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | personave të zhvendosur të rikthyer nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ? | | |
| **6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA** | | | | **Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA** |
| 6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafruar | **Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete** | 1. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegri | 1. Po. Plani lokal i veprimit për riintegrim është i miratuar dhe është në fuqi; | |
| **7.MENAXHIMI I KUFIRIT DHE MIGRACIONIT** | | | | **Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale** | 1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit?<br><br>3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?<br><br>4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar? | 1. Për numrin e të zhvendosurve nuk kemi informata, ndërsa si persona të kthyer për periudhën 2021-2022, e kemi një familje 5 anëtarëshe, të kthyer në banesen e tyre në lagjen “Ulpiana”;<br><br>2. Shtëpi të rindërtuara nuk kemi;<br><br>3. Gjatë periudhës raportuese në ZKKK 10 persona kanë përfituar asistencë nga fondi për riintegrim;<br><br>**4.** I kemi pasur 20 raste që kanë aplikuar dhe fituar për plan biznesi gjatë priudhës raportuese; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 7.2. .Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVSB) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive | **Zyra e Kryetarit të Komunës** | **1**. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj?<br><br>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?<br><br>3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?<br><br>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?<br><br>5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?<br><br>6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?<br><br>7. ? A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunen tuaj konform | 1. KKSB është themeluar më 22.3.2022 dhe është funksional;<br>2. Numri i takimeve të mbajtura gjithsej është gjashtë (6) për vitin 2022;<br>3. Këshillat lokale për siguri publike (KLSP) janë themeluar në Komunën e Prishtinës;<br>4. Sipas raportimeve të përfaqësuaesve të KLSP-ve, të gjitha takimet e parapara janë mbajtur (mujore);<br>5. Në Komunë e Prishtinës është e themeluar EVSB-ja, por nuk është funksionale, për arsye të largimit të antarëve dhe mos zëvendësimin e tyre, edhe pse kemi kërkuar nga MPB për rivitalizimin e listave të anëtarëve të EVSB-së;<br>6. Nuk kemi mbajtur takime gjatë vitit 2022 përderisa të bëhet rivitalizimi i listave;<br>7. Vendimin për themelimin e këshillave të fshatrave e gjeni në linkun më poshtë; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Udhezimi Administrativ 02/2019 MAPL per bashkpunimin e komunes me fshatra, nese po te bashkangjiten vendimet perkatese?<br><br>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë? | https://prishtinaonline.com/uploads/3._vendim_per_caktimin_e_komisionit_per_udheheqjen_dhe_koordinimin_e_punes_ne_teren_per_perzgjedhjen_e_keshillave....pdf | |
| **8. ARSIMI DHE KULTURA** | | | | **Neni 107 Arsimi dhe trajnimi - MSA** |
| 8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës | **Drejtoria e Administratës** | 1. Sa trajnime janë mbatjtur gjatë periudhës raportuese për mësimëdhënës ?<br><br>2. Numri i mësimdhënësve të trajnuar ? | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta | **Drejtoria e Arsimit** | 1. Sa është numri i çerdheve funksionale *(publike dhe jo-publike)* në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?<br><br>3.Sa është numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në çerdhe? | 1. Në Komunën e Prishtinës janë funksionale tetë (8) institucione parashkollore publike dhe nëntë (9) kopshte me bazë në komunitet;<br><br>2. Në kopshtet publike numri i fëmijëve 0 deri në 5 vjeç është 1227 dhe te mosha 5 deri 6 vjeç janë 383; Ndërsa, në kopshtet me bazë në komunitet numri i fëmijëve 0 deri 5 vjeç është 985; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit | **Drejtoria e Arsimit** | 1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët ë komuntiteteve pakicë?<br><br>2. A ka ngritur komuna e juaj shqetësimet në institucionin përkatës lidhur me mungesën e literaturës shkollore në gjuhën e komuniteteve pakicë dhe a është ndërmarr ndonjë veprim?<br><br>3.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?<br><br>4. A është zhvilluar apo implementuar ndonjë projekt lidhur me sensibilizimin e nevojës së shkollimit të fëmijëvë të këtyre komuniteteve?<br><br>5. A ka hartuar komuna | 1. Për këtë vit shkollor në komunën e Prishtinës janë furnizuar me libra shkollorë edhe komunitet pakicë, si komuniteti boshnjak dhe komuniteti turk.<br><br>2. Sigurisht, për çdo shqetësim që adresohet për literaturë nga komunitetit në Drejtorin e Arsimit, kërkesa e tilla adresohen në institucionet përgjegjëse si MASHT.<br><br>3. Për vitin shkollor 2021-2022, janë evidentuar vetëm 3 raste të braktisjes së shkollimit nga komuniteti RAE.<br><br>4. Për këtë vit shkollor organizata "Terres De Homes", ka organziuar disa aktivitete të tilla në tri shkolla fillore, si SHFMU "Asim Vokshi", SHFMU "Zenel Hajdini" dhe SHFMU "Dardania";<br><br>5. Ekipi për parandalimin e braktisjes ka filluar një planveprimi, por ende nuk ka përfunduar, pra jemi në proces. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan? | Në vazhdimësi kemi qenë në kontakt me përfaqësuesit e ekipeve të braktisjes në nivel shkolle dhe përfaqësuesit e MASHT, si sfidë mund të theksojmë se Plani i veprimit ende nuk ka përfunduar për shkak të mbledhjes së një takimi dhe diksutimit të përgjithshëm të një drafti të planveprimit. | |
| | | 6. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) ? | | |
| | | 7. A janë formuar ekpiet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në | Në të gjitha shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta, janë formuar ekipet për pranadalimin e braktisjes dhe janë funskionale. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | shkolla në komunen tuaj? | | |
| **9. MJEDISI** | | | | **Neni 115 Mjedisi- MSA** |
| 9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. Cilat janë sfidat me të cilat përballet komuna juaj gjatë zbatimit të ligjit për menaxhimin e mbeturinave<br><br>2. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/l-060 për mbeturina.Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar? | 1. Sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Komuna jonë në menaxhimin e mbeturinave, janë: mungese e stafit, kompania "Pastrimi" me mekanizëm të punës të vjetërsuar dhe numër të vogël të tyre, mungesë e kontejnerëve për mbeturinave etj.;<br>2. Po. E gjeni të bashkangjitur;<br><br>• Poashtu vlen të ceket se kemi filuar me procesin e revidimit të PKMM-së | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 3. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave?<br><br>4. Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?<br><br>5.Cilat janë veprimet e ndërrmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 6. A është hartuar plani i veprimit për cilësin e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/l-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ( *shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis*) ?<br><br>7. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar plani i veprimit për cilësin e ajrit ?<br><br>8. A harton komuna juaj raportin për zbatimin e planit për për cilësinë e ajrit dhe a shqyrtohen nga Kuvendet e Komunave këto raporte konform Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9.3. Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A ka përfshirë komuna e juaj zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planin Rregullues detajor? | | |
| 9.4. Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi? | Nga 22 deponi të evidentuara, janë larguar 20 dhe kanë mbetur 2 deponi ilegale; | |
| **10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK** | | | | **Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA** |
| 10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues | **Drejotria e Administrates/Drejtoria e shëndetësis** | 1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ?<br><br>2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës? | 1. Aktivitetet e realizuara në këtë gjysmëvit për shëndetin riprodhues, janë këto:<br>- Në QMG pranë QKMF-së nëPrishtinë, u mbajt ligjërata edukative për shtatzëna, me temat:<br>* “Ushqimi i shëndetshëm gjatë Covid 19”, ligjeruese dr. Zana Vela, endokrinologe dhe “Higjiena orale dhe e dhëmbëve gjatë Covid 19”, ligjëruese dr. Zana Sllamniku – Dalipi, stomatologe;<br>* Ligjëratat për ”Parandalimin e kancerit të qafës së mitrës”, në bashkëpunim me AMC, janë mbajtur si vijon:<br>Data: 14. 3. 2022<br>Ligjerues: Dr. Sebahat Lleshi<br>Data: 15.3.2022<br>Ligjerues: Dr. Sebahat Lleshi<br>2 .Aktivitetet e realizuara për periudhën | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | janar-qershor 2022, janë këto:<br><br>• Më 30.3.2022 dhe 31.3.2022, trajnim “Shëndeti seksual dhe riprodhues i personave me nevoja të veçanta”;<br><br>• Trajnimi 3-ditor “Infeksionet seksualisht të transmetueshme “.<br><br>• Më 13.06.2022 dhe 14.06.2022, trajnimi 2-ditor, me temë “Dhuna në baza gjinore”;<br><br>• Më 6.10.2022 dhe 12.10.2022, ligjerata “Çrregullimet e ciklit menstrual”;<br><br>• 22.11.2022-23.11.2022 dhe 6.12.2022-7.12.2022, trajnimi dyditor “Pakoja minimale fillestare e shërbimeve për shëndet seksual dhe riprodhues;<br><br>- Aktivitetet e realizuara të KEPSH:<br><br>• Më 15.6.2022, ligjërata me temën “Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës”<br><br>• Më 7, 20, 21, 25 dhe 28 tetor është shënuar Muaji i | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | luftës kundër kancerit të gjirit;<br><br>• Më 1.12.2022, u shënuar Dita boterore kundër HIV Aids, me ligjërata edukativ në SHFMUT –të prishtinës;<br><br>2. Nga Komuna e Prishtines janë organizuar pesë trajnime për shëndetin e nënës dhe fëmijës, me gjithesejt 30 pjesëmarrës; | |
| 10.2. Mbrojtja e Shëndetit Publi**k** | | 1. Sa është numri i inspektimeve për zbatimin e Ligjit kundër duhanit, gjatë periudhës raportuese?<br><br>2.Sa është numri i gjobave të shqiptuara gjatë periudhës raportuese? | 1. Gjatë periudhës janar - dhjetor janë inspektuar shtatë Qendra të Mjekësisë Familjare;<br><br>2 . Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë gjobë; | |